



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 10.11/2025
Numër Protokolli: 7311/2025

A.nr.1787/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1787/2025, të datës 13.10.2025, të parashtruar nga ankuesja T.K.H, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit/Ministrit të Shëndetësisë, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia juridike*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1787/2025, e datës 13.10.2025, e parashtruar nga ankuesja T.K.H.

A r s y e t i m

Nëpunësja Civile, T.K.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 13.10.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli:6733/2025, kundër 01.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore për shkak të mos hapjes së procedurës sipas kërkesës së ankueses të datës 26.09.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit me datë 22.10.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) **për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6733/2025 të datës 13.10.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Akt Emërimit të ankueses të datës 23.12.2024; Vendimin e datës 11.11.2024 të DMZP-së; E-mail i datës 07.10.2024 dërguar nga A.M tek ankuesja me korrespondencën e bashkangjitur; Përgjigjen e datës 01.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore përmes E-mailit drejtuar ankueses me korrespondencën e bashkangjitur; Kopjen e ID-së së ankueses; E-mailin e datës 10.10.2025 dërguar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.10.2025; Përgjigje në ankesë e datës 22.10.2025; Vendimin e datës 02.08.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së, Njoftimin e datës 02.08.2025 dërguar për ankuesen; Vendimin e datës 12.09.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së; Kërkesën e datës 06.11.2025 dërguar nga këshilli për A.M; përgjigjen e datës 06.11.2025 dërguar nga A.M për Këshillin; Përgjigjen e datës 07.10.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe sipas Akt të Emërimit të datës 23.12.2024 mban pozitën e punës *“Zyrtar i lartë për planifikim infrastrukturor”*, në kuadër të Divizionit për Planifikim Strategjik.

Tutje, ankuesja më datë 26.09.2025 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me kërkesën për rihapje të procedurës administrative që ndërlidhet me kërkesën e saj të datës 27.05.2024, kërkesë kjo e trajtuar sipas Vendimit të datës 02.08.2024 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me pretendimin se e njëjta nuk ka qenë e njoftuar me vendimmarrjen e Këshillit sipas Vendimit A.nr.801/2024 të datës 24.07.2025 dhe me arsyetimin se gjatë periudhës përkatëse ka qenë në pushim mjekësor duke u trajtuar jashtë vendit, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 01.10.2025 i është përgjigjur ankueses në kërkesë e saj të datës 26.09.2025 me shpjegimin se organi i punësimit, respektivisht Sekretari i Përgjithshëm duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.801/2024, e ka shqyrtuar kërkesën e ankueses të datës 27.05.2024 dhe njëherit e ka refuzuar kërkesën në fjalë sipas Vendimit Nr.05-5987 të datës 02.08.2024, ndërsa me datë 02.08.2024 të njëjtin vendim ia kanë dërguara ankueses në e-mailin e saj zyrtar me qëllim të njoftimit se kërkesa e saj është shqyrtuar.

Ankuesja kundër përgjigjes së datës 01.10.2025 ka parashtruar ankesë kundër veprimeve të organit të punësimit, për shkak të mos hapjes së procedurës sipas kërkesës së saj të datës 26.09.2025, me pretendimin ankimor se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 02.08.2024, nuk ka vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.801/2024 të datës 24.07.2024 me arsyetimin se Këshilli e kishte aprovuar ankesën e ankueses të datës 10.06.2024 dhe se Sekretari i Përgjithshëm nuk ka vepruar sipas vendimmarrjes së Këshillit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses për rihapjen e administrative të procedurës pranë organit të punësimit, Kolegji i këshillit analizoi dhe mori për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 104 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Për të kundërshtuar një akt administrativ, afati për parashtrimin e ankesës ndaj të cilit ka kaluar, pala mund të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse pas kalimit të afatit për ankesën është njohur me ekzistencën e njërit prej këtyre shkaqeve: 1.1. situata faktike apo ligjore mbi të cilin bazohej lëshimi i aktit administrativ të kundërshtuar, ka ndryshuar në të mirë të palës; 1.2. janë zbuluar prova të reja, të cilat, po të kishin qenë*

të ditura në kohën e vendimmarrjes, mund të kishin ndikuar në lëshimin e aktit të administrativ të kundërshtuar; 1.3. pas lëshimit të aktit, ka ndryshuar praktika administrative për çështje të njëjta apo të ngjashme administrative. 2. Pala nuk ka të drejtë të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse mosnjohja e shkaqeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni i detyrohet neglizhencës të saj”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses nuk gjen mbështetje ligjore, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet që ankuesja ka shfaqur neglizhencë juridike në rrethanat e rastit konkret, ngase organi i punësimit Vendimin e datës 02.08.2024 ia kishte përcjellë ankueses përmes e-mailit zyrtar po në të njëjtën datë 02.08.2024, ndërsa po ashtu konfirmohet fakti se ankuesja me datë 23.12.2024 e ka nënshkruar aktin e ri të emërimit, dhe ka qenë prezentë në vazhdimësi në punë që nga data 16.10.2024, dhe pothuajse gati për një (1) vit, nuk ka shfaq asnjë interes juridik lidhur me shkresën apo aktin në fjalë, përveç tjerash aktin në fjalë e ka pasur ne emalin e saj zyrtar që nga data 02.08.2024.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendimi ankimor i ankueses se Këshilli përmes Vendimit A.nr.801/2024 të datës 24.07.2024 ia ka njohur të drejtën në kompensim ankueses duke e detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të veproi në atë mënyrë, është pretendim i paqëndrueshëm dhe nuk ka mbështetje në asnjë argument juridik, pasi që Këshilli përmes Vendimit A.nr.801/2024 të datës 24.07.2024 e kishte aprovuar ankesën e ankueses të datës 10.06.2025 në kuptim të pretendimit ankimor të saj për mungesën e elementeve të detyrueshme të aktit administrative lidhur me përgjigjen e pranuar me datë 28.05.2024 nga Njësia e Burimeve Njerëzore, gjegjësisht ankuesja i ishte drejtuar me kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm dhe jo Njesisë së Burimeve Njerëzore, prandaj Këshilli e kishte detyruar Sekretarin e Përgjithshëm i MSH-së, të shqyrtoi kërkesën e ankueses të datës 27.05.2024 sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara të LPPA-së, gjegjësisht vendimi i Këshillit ka qenë vendim i ndërmjetshëm dhe e ka detyruar organin e punësimit të ndërmarrë veprime juridike administrative sipas dispozitave të aplikuara të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me kërkesën e palës ankuese, ndërsa për rastin në fjalë nuk është vendosur meritorisht për çështjen, ngase ka munguar akti administrativ dhe në mungesë të tij nuk ka pasur objekt të qartë shqyrtimi në të cilën do të konstatohesh shprehja e qëndrimit apo autoritetit publik nga organi i punësimit në kërkesën e ankueses të datës 27.05.2024.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi duke e refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1787/2025, datë 10/11/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses T.K.H;
- Ministrisë e Shëndetësisë (*Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.